



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 12.06.2025

V E N D I M

Nr.7, datë 12.06.2025

PËR

**“MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT: “PROJEKT-
RREGULLORE PËR ZBATIMIN E PORTABILITETIT TË NUMRIT””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 12.06.2025, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Projekt-Rregullore për zbatimin e portabilitetit të numrit”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 146 i Ligjit 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 54/2024);
2. Rregullore “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr.21, datë 7.12.2021.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti i përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave dhe Inspektimit për këshillim publik: *"Projekt-Rregullore për zbatimin e portabilitetit të numrit"*;
2. Projekt-Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;

V Ë R E N:

1. Ligji nr.54/2024 *"Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"* hyri në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar Ligjin 9918/2008 *"Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar. Ligji i ri 54/2024 ka përafruar pjesërisht në legjislacionin kombëtar Direktivën (EU) 2018/1972 të parlamentit Evropian dhe të Këshillit *"Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike"* (në vijim EECC), dhe përmban një sërë përcaktimesh të reja në lidhje me portabilitetin e numrit, të cilat nuk kanë qenë pjesë e Ligjit 9918/2008.
2. Ligji 54/2024 në Nenet 126, 145, 146 dhe 180 përmban përcaktime mbi të drejtat e përdoruesve fundorë dhe detyrimet e sipërmarrësve në lidhje me portimin e numrit dhe ndërrimin e ofruesit të shërbimit nga përdoruesit fundorë, një pjesë e të cilave nuk kanë qenë pjesë e përcaktimeve të Ligjit 9918/2008 ose kuadrit nënligjor përkatës ekzistues. Këto përcaktime të reja të Ligjit 54/2024 në lidhje me portabilitetin e numrit dhe ndërrimin e ofruesit të shërbimit, përfshijnë ndër të tjera:
 - Përcaktimet në pikat 1-3 të Nenit 145 në lidhje me ndërrimin e ofruesit të shërbimit të aksesit në internet të cilat synojnë garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të këtij shërbimi për përdoruesin fundor në rastet e ndërrimit të ofruesit të shërbimit, që ky process të kryhet brenda një kohe sa më të shkurtër dhe mungesa e shërbimit për përdoruesin fundor gjatë këtij procesi të mos jetë më e gjatë se një ditë pune;
 - Përcaktimet në pikën 5 të nenit 145, që një përdorues fundor ruan të drejtën për portimin e numrit të një ofrues tjetër, për të paktën një muaj nga data e përfundimit të kontratës ekzistuese me operatorin/ofruesin dhënës, përveç rastit kur përdoruesi fundor heq dore nga kjo e drejtë.
 - Përcaktimet në pikën 12 të nenit 145, në lidhje me detyrime për procesin e portimit dhe për operatorët e rrjetit të aksesit apo faciliteteve të tyre që përdoren nga ofruesi dhënës apo marrës ose nga të dy bashkë, të cilat janë të aplikueshme në rastet kur sipërmarrësit ofrojnë shërbimet e komunikimit zanor duke përdorur rrjetin e një operatori/sipërmarrësi tjetër. Këto përcaktime mund të jenë të aplikueshme në rastet e MVNO-ve për shërbimet celulare (MVNO përdor rrjetin e aksesit të MNO-së) ose ofruesit të shërbimit të telefonisë fikse nëpërmjet rrjetit të aksesit të një operatori operator/sipërmarrësi tjetër fikse, me/ose pa detyrime për FNT për LLU (local loop unbundling);

- Përcaktimet në pikën 15 të Nenit 145 në lidhje me detyrimet e operatorit dhënës/ofruesit transferues për rimbursim, sipas kërkesës, të konsumtarorëve për kreditet e mbetura ose të papërdorura të tyre në përdorimin e shërbimeve me parapagim;
 - Përcaktimet në pikën 17 të nenit 145, dhe pikat 1/c/ii dhe 1/c/iii të Nenit 180 të ligjit 54/2024, në lidhje me informimin e pajtimtarit për të drejtat e portimit dhe të kompensimit dhe informacionin që duhet të përmbajë kontrata e ofrimit të shëbimit/pajtimit për të drejtën pajtimtarit për kompensim dhe rimbursim për rastet e vonesave ose abuzimeve gjatë procesit të ndërrimit të ofruesit të shërbimit, si dhe informacion në lidhje me procedurat përkatëse, si dhe për rimbursimin e krediteve të mbetura për shërbimet me parapagim.
3. Neni 146 i Ligjit 54/2024 përcakton se AKEP nëpërmjet një rregulloreje të veçantë përcakton mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit dhe afatet kohore përkatëse, duke mbajtur parasysh kërkesat e Nenit 145 të ligjit.
 4. Portabiliteti i numrit nisi të zbatohet në Shqipëri në vitin 2011 sipas përcaktimeve të neneve 87-88 të ligjit 9918/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore përkatëse të nxjerra nga AKEP në vitin 2010, të cilat përfshinin Rregulloren nr. 13/2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, nr.1219, datë 07.04.2010, si dhe dokumentin, “Specifikime teknike për zbatimin e portabilitetit të numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1318, datë 14.06.2010, nëpërmjet të cilit u kryen dhe procedurat përkatëse për ngritjen dhe funksionimin e bazës së të dhënave referencë të centralizuar të portabilitetit (CRDB).
 5. Rregullorja nr.13/2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, ka qenë objekt i disa ndryshimeve ndër vite, dhe në vitin 2016 u zëvendësua me Rregulloren nr. 43/2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.2689, datë 22.09.2016.
 6. AKEP në vitin 2018 kreu disa ndryshime në Rregulloren nr.43/2016 që synonin përmirësimin e procesit të portimit të numrit për të adresuar kryesisht problematikat e evidentuara në lidhje me përqindjen e lartë të refuzimit të kërkesave për portim të numrit celular për shkak të mospërputhjes së ID. Këto ndryshime patën efekt pozitiv në reduktimin e ndjeshëm të përqindjes së refuzimeve në periudhën 2018-2019, por në periudhën 2020-2024 është vënë re një rritje ndjeshme e numrit të ankesave të pajtimtarëve të lidhura me portimin e numrit celular, si dhe një rritje sërisht e përqindjes së kërkesave të refuzuara nga operatorët celularë. Pavarësisht proceseve të monitorimit/inspektimit dhe masave administrative dhe rekomandimeve të AKEP ndaj operatorëve celularë, si dhe rënies së numrit të ankesave të pajtimtarëve gjatë vitit 2024 dhe tremujorin e parë 2025, AKEP ka konsideruar të nevojshme ndryshimin e Rregullores 43/2016 me qëllim adresimin e problematikave të evidentuara për refuzimin e kërkesave për portim të numrit celular.
 7. Kuvendi i RSH nëpërmjet rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së AKEP për vitin 2023, ka rekomanduar që AKEP gjatë vitit 2024 krahas proceseve të monitorimit/inspektimit të zbatimit nga operatorët të detyrimeve dhe rekomandimeve të lëna në inspektimet e

mëparshme, të rishikojë Rregulloren e Portabilitetit duke synuar përmirësimin e procesit të portimit, veçanërisht përmes vendosjes së detyrimeve dhe përgjegjësiave edhe për operatorin dhënë për informimin e pajtimtarit për arsyet e refuzimit të kërkesës për portim.

8. Në përputhje me përcaktimet e Nenit 146 dhe pikës 3 të Nenit 191 të Ligjit 54/2024, AKEP ka përgatitur dokumentin “Projekt-Rregullore për zbatimin e portabilitetit të numrit”. i cili do të jetë objekt i këshillimit publik me palët e interesuara.
9. Dokumenti për këshillim publik “Projekt-Rregullore për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”:
 - është një dokument i rëndësishëm rregullator i përgatitur nga AKEP në kuadër të hartimit të akteve nënligjore përkatëse të nevojshme për zbatimin e Ligjit 54/2024 dhe rekomandimeve të Kuvendit të RSH për AKEP;
 - përmban propozimin e AKEP për projekt-rregulloren e re të portabilitetit të numrit që do të zëvendësojë rregulloren aktuale të portabilitetit (Rregulloren 43/2016) me qëllim reflektimin e përcaktimeve të reja ligjore në lidhje me portabilitetin e numrit sipas Nenit 145 (pikat 5, 12, 15 dhe 17) të Ligjit 54/2024 si dhe adresimin e problematikave të evidentuara në vitet e fundit në lidhje me refuzimet e kërkesave për portim të numrit;
 - nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të Neneve 126, 145 dhe 146 të Ligjit 54/2024;
 - ka marrë parasysh praktika më të mira në vendet e BE/BEREC në lidhje me portabilitetin e numrit;
10. Bazuar në nenet 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024, dhe Rregullore “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr.21, datë 7.12.2021, dokumenti i miratuar nëpërmjet këtij vendimi do të nxirret për këshillim publik, me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “*Projekt-Rregullore për zbatimin e portabilitetit të numrit*”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Proçedura e këshillimit publik të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit sipas pikës 3 më poshtë.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti për këshillim publik “*Projekt-Rregullore për zbatimin e portabilitetit të numrit*”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.

4. Ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave dhe Inspektimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Bleron Dokle	Lorenc Bako	Armer Juka